



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.16/2026

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skënder Çoqaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike pa njoftim paraprak në KKZ, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.06.2026, merr këtë:

#### VE N D I M

**REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa ZP.Anr.16/2026 e datës 04.06.2026, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me pretendimin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka mbajtur tubim publik pa njoftim paraprak në KKZ gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026.

#### A r s y e t i m

Me datën 04.06.2026 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike (LDK), dega në Prishtinë, në të cilën pretendohet për shkelje të rregullave të fushatës zgjedhore nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, lidhur me organizimin e një tubimi politik pa njoftimin e detyrueshëm paraprak në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Sipas Rregullores së KQZ-së për Fushatën Zgjedhore, subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik është i obliguar të dorëzojë përmes emailit formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), si në vijim: Në nenin 4, paragrafin 3, nën paragrafin 3.1 dhe nën paragrafin 3.2, të cilat përcaktojnë se: *“Subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik duhet ta dorëzojë përmes emailit formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se: 3.1. Njëzet e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës; 3.2. Dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës.”*

Më datë 02 qershor 2026 është mbajtur një takim politik në lokalin “Pollison Kafe”, në të cilin ka qenë i pranishëm kandidati për Kryeministër, z. Albin Kurti. Takimi është zhvilluar në kuadër të aktiviteteve zgjedhore dhe përbën tubim politik sipas legjislacionit dhe

rregullave të fushatës zgjedhore. Tutje ka theksuar se deri në momentin e paraqitjes së kësaj ankese, ekzistojnë dyshime nga aktivistët tonë të bazuara se për këtë aktivitet nuk është bërë njoftimi paraprak në KKZ sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara me rregullore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kanë kërkyar masën e sanksionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë ka bashkangjitur foto lidhur me njoftimin e bërë nga Lëvizja Vetëvendosje dhe linkun që kandidati për Kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosjes Albin Kurti ka qenë në tubim: <https://www.facebook.com/share/r/1BJ3BCJ05B/>

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.06.2026, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) i kundërshton pretendimet e ankesës së parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kërkon që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, për shkak se pretendimet e saj nuk mbështeten në prova të mjaftueshme dhe nuk arrijnë standardin e kërkuar për të vërtetuar shkeljen e pretenduar. Ankuesi pretendon se aktiviteti i mbajtur më 02 qershor 2026 në lokalitetin "Pollson Caffè" në Fushë Kosovë është organizuar pa njoftimin paraprak në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve. Megjithatë, nga vetë përmbajtja e ankesës rezulton se ky pretendim nuk mbështetet në ndonjë provë konkrete, por vetëm në dyshime të shprehura nga aktivistët të subjektit ankues. Në ankesë thuhet shprehimisht se "*ekzistojnë dyshime*" se nuk është bërë njoftimi paraprak në KKZ. Ankuesi nuk ka bashkëngjitur asnjë dokument zyrtar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, as ndonjë konfirmim nga autoriteti kompetent, që do të dëshmonte se një njoftim i tillë nuk është paraqitur. Për pasojë, pretendimi mbetet në nivel të supozimit dhe jo të një fakti të provuar. Sipas parimeve themelore të procedurës ankimore, barra e provës bie mbi palën që pretendon ekzistimin e shkeljes. PZAP nuk mund të mbështesë konstatimin e përgjegjësisë së një subjekti politik vetëm mbi dyshime apo hamendësime, por duhet të mbështetet në prova konkrete dhe të verifikueshme. Po ashtu, ankuesi nuk ka pretenduar e as provuar se aktivitetit në fjalë ka shkaktuar ndonjë pasojë konkrete në procesin zgjedhor, ka penguar ndonjë subjekt tjetër politik në ushtrimin e të drejtave të tij, ka cenuar rendin publik apo ka krijuar konflikt me ndonjë aktivitet tjetër të paralajmëruar. Për rrjedhojë, duke qenë se ankesa nuk mbështetet në prova të mjaftueshme dhe nuk vërteton ekzistimin e shkeljes së pretenduar, propozojmë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ta refuzojë atë në tërësi si të pabazuar.

PZAP lidhur me ankesën ZP.Anr.16/2026 e parashtruar nga subjekti politik LDK, kundër subjektit politik LVV, i është drejtuar KQZ-së me kërkesë për përgjigje në ankesë me datë 04.06.2026 për sqarimin të më tutjeshëm lidhur me rastin.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.06.2026, KQZ lidhur me rastin në fjalë ka sqaruar se bazuar në nenin 44 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i jep kompetencë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të miratuar rregulla specifike që lidhen me organizimin e ngjarjeve politike gjatë fushatës zgjedhore. Në bazë të kësaj kompetence KQZ ka miratuar Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar - Organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike, ku në nenin 4 specifikohet procedura e organizimit dhe mbajtjes së tubimeve publike. Sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në Institucionet arsimore, sportive dhe

kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që lloj të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ. Sipas paragrafi 3 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë përmes emailit, formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se, njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës. Sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, KKZ, pas pranimit të formularit nga subjekti politik, e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimit të njoftimit. KKZ, jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe Zyrën Për qëllime të monitorimit. Sipas paragrafit 12 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, mosmarrëveshjet në lidhje me mbajtjen e ndonjë ngjarje politike në vendet publike shqyrtohen dhe zgjidhen nga PZAP. Raportet e policisë në lidhje me trazirat në ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion PZAP dhe KQZ.

Andaj, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, KQZ ka kontaktuar me zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Fushë Kosovë të cilët kanë njoftuar si në vijim *“Në Zyrën e KKZ-së në Fushë-Kosovë nuk kemi pranuar asnjë njoftim nga subjekti politik Vetëvendosje për mbajtjen e ndonjë tubimi në datën e cekur. Bashkëngjitur gjendet edhe regjistri i tubimeve politike, në të cilin janë evidentuar kërkesat e paraqitura nga subjektet politike për mbajtjen e tubimeve të tyre.”* (Të bashkëngjitur njoftimin e ZEKKZ).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore nga ankesa si dhe përgjigjen në ankesë, vëren se:

- **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkëngjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është shkaktuar shkelje e dispozitës së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politik, përkatësisht, mbajtja e tubimit publik pa njoftim paraprak në KKZ sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në rregullore.

Nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehen vetëm se është realizuar një tubim nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilin tubime kanë marrë pjesë disa persona, por nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe bindëse se tubimi është mbajtur në objekt publik si dhe i njëjti është organizuar pa njoftimin paraprak në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, ashtu siç pretendohet nga pala ankuese, pasi që provat e ofruara, fotoja e bashkëngjitur lidhur me thirrjen e mbajtjes së tubimit është paraqitur një hapësirë private, si dhe nga video e ofruar nuk shihet se tubimi është bërë në hapësirë publike. Sipas nenit 4 paragrafin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, *“Subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ”*. Po ashtu, bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës *“1. Sipas kushteve të saktësuara në Kodin e Sjelljes, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore,*

subjektet politike kanë të drejtë: 1.1. të organizojnë dhe mbajnë tubime/ngjarje politike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre...” Rrjedhimisht, subjekti politik LDK si parashtrues i ankeses nuk ka ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse të cilat vërtetojnë se subjekti politik LVV ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore gjatë fushatë zgjedhore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që pretendimet ankimore kanë qene te paargumentuara, jo bindëse, sipërfaqësore dhe jo te konkretizuara, andaj paneli e refuyoi ankesën si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZP.Anr.16/2026, më datë 05.06.2026

**Kryesuese e Panelit**

Kymete Kicaj



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.